



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

Kodi: 060

**KEC**

## **KOSOVISION CONTEST**

### TRAJNIMI PËR MËSIMDHËNËS

Tipi i Programit: Themelor

#### Historiku i Programit

Që prej vitit 2008, projekti Kosovision promovon vlera të qytetarisë demokratike në mesin e fëmijëve, duke iu mundësuar nxënësve të klasave të pesta në mbarë Kosovës që të zgjedhin dhe të zbatojnë projekte të vogla, dhe i cili është zbatuar me sukses nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut (SHLPC) dhe nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), të mbështetura financiarisht prej SDC- së, KFOR-it dhe Fondit të Lotarisë së Cyrihut, MASHT-it dhe donatorëve të tjerë privatë.

KOSOVISION CONTEST është një projekt arsimor në formë të një gare kombëtare që përcillet nga media. Pjesëmarrës në këtë projekt janë të gjitha klasat e pesta së bashku me mësimitdhënësit e tyre. KOSOVISION CONTEST u mundëson fëmijëve që duke marrë pjesë në projekt të kontribuojnë për të ardhmen e vendit të tyre. Ata inkurajohen që të shprehin vizionet e tyre dhe bëhen aktiv në shoqëri. Për nga përmbajtja fëmijët merren me tema nga mjedisi i tyre jetësor. Ato janë: arsimimi, infrastruktura, ekonomia dhe bashkëjetesa në Kosovë. Fëmijët mendojnë për të arriturat e deritashme në Kosovë dhe për gjërat që ende u mungojnë. Kërkojnë rrugëzgjdhje dhe zhvillojnë vizione për një të ardhme më të mirë që i shprehin me vizatime.

Përveç kësaj, fëmijët japin ide se si ata vet mund të kontribuojnë për të ardhmen. Japin një projekt ide. Pllakati me vizionet dhe projekt ideja dorëzohen për pjesëmarrje në garë. Të gjitha klasat pajisen me certifikatë, punimet më të mira shpërblehen dhe pllakatet ekspozohen.

#### Qëllimet e programit:

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë gjendje:

- T'i përshkruajnë, t'i shpjegojnë dhe t'i demonstrojnë konceptet themelore për të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës;
- Të shpjegojnë, të argumentojnë dhe të demonstrojnë zhvillimin dhe evoluimin historik të Kosovës;

- Të njoftohen me ecurinë dhe qëllimet e programit KOSOVISION CONTEST;
- Të përshkruajnë metodologjitë e mësimdhënies dhe të përgatitjes së materialeve për edukimin dhe njohuri për temat e dhëna në projekt;
- Të aktivizohen si trajnerë, avokatë, fasilitatorë apo vullnetarë në fuqizimin e ideve të dhëna nga vet nxënësit;
- Të organizojnë trajnime, këshillime, ligjërata dhe ekspozë të ndryshme me temat e dhëna;
- Të ndihmojë klasat në procesin e zhvillimit të koncepteve dhe në procesin e implementimit të projekteve shkollore;
- Të krijojë kushte të nevojshme për punë në klasë;
- Të udhëheqin bisedat në klasë dhe të mbështesin nxënësit gjatë punës;

#### Përmbajtja:

- 1. Konceptet themelore për promovimin e edukimit qytetar.** Aftësimi i mësimdhënësve për edukimin qytetar dhe demokratik. Koncepti i arsimit qytetar dhe demokratik. Karakteristikat më të rëndësishme të demokracisë. Përgjegjësia personale dhe shoqërore. Të kuptuarit e kulturave të tjera. Qytetaria aktive në shkollë.
- 2. Roli dhe ndërveprimi i qytetarëve në një shoqëri demokratike.** Natyra e bashkëpunimit dhe konkurrimit mes individëve, grupeve dhe komunitetit. Koncepti i barazisë dhe diversitetit mes individëve dhe grupeve.
- 3. Konceptet themelore për vizionin.** Adresim i çështjeve për zhvillimin e marrëdhënieve me familjet dhe komunitetin (bashkëjetesa). Përvetësimi i përgjegjësive personale dhe shoqërore. Shkathhtësi komunikimi me të tjerë.
- 4. Komuniteti.** Roli i komunitetit. Bashkëpunimi me komunitetin. Negocimi dhe konsensusi. Zgjidhja e problemit në komunitet.
- 5. Shoqëria.** Koncepti i shoqërisë njerëzore. Nevojat e përbashkëta të një shoqërie. Krahasimi i shoqërisë së sotme me shoqëritë e mëhershme. Rregullat e domosdoshme që duhet zbatuar në një shoqëri. Interesat e përbashkëta të një shoqërie (infrastruktura, ekonomia-rol i qytetarit në ekonomi).
- 6. Qytetari dhe mjedisi natyror.** Njeriu, shëndeti, mjedisi dhe çështjet ekologjike. Roli i qytetarit në mbrojtjen e mjedisit.
- 7. Metodologjia e punës në projekte.** Mësimi i bazuar në projekte. Aktivizimi për punë në projekte. Ndërmarrja e aktiviteteve praktike. Njohja e metodologjisë, modele të reja. Zgjerim i njohurive. Krijim vizioni dhe kompetencë veprimi. Planifikimi, orari i aktiviteteve, monitorimi, vlerësimi dhe reflektimi. Përgatitja e formularëve.
- 8. Monitorimi dhe vlerësimi.** Qëllimi i monitorimit. Planifikimi dhe zbatimi. Programi i vlerësimit.

### Grupi i synuar

Ky program u dedikohet të gjithë mësimdhënësve të klasave të pesta.

### Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Ky program organizohet në formën e kursit 3 ditësh. Kursi zgjatë **24 orë**. Numri optimal i pjesëmarrësve është 25-30.

### Vlerësimi/Certifikimi

Certifikimi për pjesëmarrje në program bëhet në përputhje me kriteret dhe standardet e Programit. Ato janë: Vijueshmëria e rregullt pjesëmarrësve, dosja me punime dhe intervistat.

### Materialet e trajnimit – Përmbajtja

1.	Pasqyra mbi projektin KOSOVISION CONTSET	1 faqe
2.	Udhëzime për mësimdhënie.	1 doracak (30 faqe)
3.	Shtojca 1: Fjalë dhe tituj që kanë të bëjnë me arsimin, infrastrukturën dhe mjedisin, ekonominë dhe bashkëjetesën.	15 faqe
4.	Shtojca 2: Detyra lidhur me arsimin, infrastrukturën dhe mjedisin, ekonominë, bashkëjetesën.	4 faqe
5.	Shtojca 3: Fletët e projektit për aplikim në garë.	2 faqe